

VENDIM
Nr.350, datë 10.8.1992

PËR MËNYRËN E KLASIFIKIMIT TË NDËRMARRJEVE SHETËTËRORE NË
KOMBËTARE OSE LOKALE

Në zbatim të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërmarrjet shtetërore klasifikohen në ndërmarrje kombëtare ose lokale në varësi nga madhësia e tyre, rëndësia e veprimtarisë ekonomiko-financiare që kryejnë, vendndodhja e shtrirja territoriale, destinacioni i mallrave të prodhuara, burimet kryesore të furnizimit dhe ndonjë treguesi tjetër specifik.

2. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore bëjnë zbërthimin konkret të treguesve sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe, brenda datës 17 gusht 1992, bëjnë ndarjen e ndërmarrjeve ekzistuese në vartësi të tyre dhe të organeve të pushtetit lokal. Këto ndarje kanë karakter detyrues për organet e pushtetit lokal.

Gjithashtu ndryshimi i klasifikimit të ndërmarrjeve shtetërore nga kombëtare në lokale e anasjelltas dhe klasifikimi i ndërmarrjeve të reja shtetërore miratohen nga ministria ose institucioni tjetër qendror.

Mosmarrëveshjet ndërmjet Ministrisë, institucionit tjetër qendror dhe organit përkatës të pushtetit lokal, për klasifikimin e ndërmarrjeve shtetërore zgjidhen nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi